REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
LUSHNJË

Nr. 9417/2 **prot** **Lushnje,më** 02/12/**2024**

VENDIM
Nr. 103 **Datë** 26/11 **/2024**

"PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE. ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINE E LUSHNJËS DHE PENALITETET PËR KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025"

Këshilli i Bashkisë Lushnjë në mbledhjen e tij të datës së 26/11/2024, bazuar në nenin 5 gërma "b",neni 9,20,22,23,26,27,28,32dhe 33 të Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar me Ligjin Nr. 181/2013, date 28.12.2013; Ligj Nr. 85/2014, date 17.07.2014; ligjit nr. 139/2015 date 17.12.2015 *"Per veteqeverisjen vendore"*, i ndryshuar, neni 9 pika 1.1 gërma "a" dhe "b",pika 1.3 gërma "b",neni 54 germa "f" dhe "k", Ligjin nr 9920 datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit të Financave nr 24 datë 02.09.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar; ligjit nr. 107/2014, date 31.07.2014, "Për Planifikimin dhe zhvillimin e Territorit", i ndryshuar; ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative"; ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin,transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" i ndryshuar; Ligjit nr.9723 datë 03.05.2007"Per Regjistrimin e biznesit", i ndryshuar; neni 6 i Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",Ligjit Nr.8378 dt 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikes së Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjit nr.44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; VKM 283, date 01.04.2015 "për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore"i ndryshuar, VKM nr.132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës ' i ndryshuar',Ligjit Nr. 89/2022 "Për Policinë Bashkiake", Ligjit nr.10 431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar,neni 31,32,dhe 33 të Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave", neni 11, neni 12, neni 27, neni 35, neni 37 dhe neni 38, Ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, Vendimit nr. 99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", i ndryshuar,Udhëzimit Nr. 6 datë 11.04.2022"Për mjetet që përdoren për peshkimin

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-bashkia_lushnje @ yahoo.com
Web:www.bashkia lushnje.gov.al

çlodhës-argëtues dhe mënyrën e lëshimit të autorizimit" dhe të gjitha akteve të tjera nenligjore për zbatimin e ligjeve të sipërcituara Ju :

VENDOSI:

I-Të miratojë nivelet e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Lushnje për vitin 2025 si më poshtë:

PJESA I
PJESA E PËRGJITHSHME

TITULLI I
TAKSAT VENDORE QË APLIKOHEN NË TERRITORIN E BASHKISË LUSHNJE

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky vendim përcakton llojet e taksave dhe tarifave vendore që zbatohen në territorin e Bashkisë Lushnje,nivelin e taksave dhe tarifave, procedurat e llogaritjes, baza tatimore, kategorizimet dhe nënkategorizimet, lehtësimit apo përjashtimit, arkëtimit dhe transferimit në buxhetin e bashkisë, si dhe detyrimet që kanë agjentët për mbledhjen e taksave dhe tarifave.

Neni 2
Llojet e taksave

1. Në Bashkinë Lushnje aplikohen këto taksa vendore:
   a) Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi token bujqësore dhe taksa mbi truallin;
   b) Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
   c) Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
   d) Taksa e fjetjes në hotel;
   e) Taksa e tabelës;

2. Përjashtohen nga taksat vendore të gjitha subjektet e parashikuara shprehimisht në këtë vendim apo në akte ligjore dhe nënligjore të veçanta.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllime të zbatimit të taksës së ndërtesës në Bashkinë Lushnje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
1. "Agjent i mbledhjes së taksave dhe tarifave" është personi i cili, sipas kërkesave të këtij vendimi,është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogarinë e Bashkisë Lushnje apo strukturave të saj, të të ardhurave nga taksat dhe tarifat.



2. "Pasuri e paluajtshme" janë trualli, toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.
3. "Kadastra fiskale" është regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërbenpër qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.
4. "Drejtoria e të Ardhurave Vendore", struktura për administrimin e taksave dhe tarifave vendore pranë Bashkisë Lushnje.
5. "Niveli tregues i taksës" janë nivelet e taksave të parashikuara sipas këtij vendimi.
6. "Çmim vlerësues", njësia matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar.
7. "Ndërtesë", objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në vendim.
8. "Ndërtesë e papërfunduar", objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese,për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
9. Njësi pronësore", ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë". Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.
10. "Ndarje e njësisë pronësore për banim", pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.
11. "Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike", pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.
12. "Përdorues", individi, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/ njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.
13. "Taksë" është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e Bashkisë Lushnje që paguhet nga çdo person apo nëpërmjet një agjenti që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik në territorin e Bashkisë Lushnje.
14. "Tarifë" është pagesa, që një individ, person fizik apo juridik, bën drejtpërdrejt apo nëpërmjet një agjenti tek administrata e Bashkisë Lushnje. Pagesa bëhet në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë.
15. "Taksapagues", çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, i cili është i detyruar të paguajë njërën nga taksat vendore të përcaktuar në ketë vendim apo legjislacionin në fuqi.
16. "Vlerë e pasurisë", është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore.
17. "Veprimtari ekonomike", është çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi I pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

KREU II

TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Neni 4
Taksa mbi pasuritë e paluajtshme

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:
1. Taksa mbi ndërtesat.
2. Taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa mbi truallin.

Neni 5
Taksa mbi ndërtesën

1. Taksa mbi ndërtesën zbatohet në përputhje me parashikimet dhe përcaktimet e ligjit nr. 9632, date 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, vendimit nr. 132, datë 07.03.2018, "Për metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit, të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve e rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", të ndryshuar, si dhe çdo akti tjetër që normon këtë proces.
2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në ligj përcaktohen ndryshe.
3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar.
4. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
5. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
6. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit.

Neni 6
Çmimi mesatar referues për përllogaritjen e taksës

ÇMIMET MESATARE REFERUESE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR VLERËSIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME PËR NDËRTIME DHE AMBIENTE JO-BANIMI

a) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë.
b) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-bashkia_lushnje @ yahoo.com
Web:www.bashkia lushnje.gov.al

c) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbolli, minifutbolli, basketbolli, volejbolli, tenisi,golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

d) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si:prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve tëgatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteveushqimore (përjashtuar ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera tëngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse,sipas qyteteve.

Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura.

e) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari

mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësorë dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

Neni 7
Shkalla e taksës mbi ndërtesat

1. Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është:
   a. 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
   b. 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
   c. 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
3. Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës, të përcaktuar në aktin e lejes së ndërtimit apo aktin e regjistrimit pranë regjistrave të pasurive të paluajtshme:

   a. Apartamente banimi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "ndërtesa që përdoret,shfrytëzohet për banim".
   b. Njësi biznesi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike".
   c. Bodrum/parking i mbuluar do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "ndërtesa që përdoret për parkim të mbuluar dhe bodrume".

4. Kur nga verifikimi në terren rezulton se ndërtesa apo njësi të veçanta të saj janë vënë në përdorim/shfrytëzim, pavarësisht se ndërtesa në tërësi nuk ka përfunduar, taksa llogaritet e plotë për pjesën në përdorim/shfrytëzim. Në këtë rast, baza e taksueshme llogaritet me kostot e ndërtimit për pjesën e papërfunduar dhe me çmimet vlerësuese për pjesët e vëna në përdorim. Për

pjesë të ndërtesës të vëna në përdorim, baza e taksës do të jetë e plotë. E njëjta situatë vlen edhe kur nuk është dhënë leja e shfrytëzimit të ndërtesës apo nuk është bërë regjistrimi në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

5. Sipërfaqja e prezumuar.

Për ndërtesat që përdoren, shfrytëzohet për banim, identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

a. 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;

b. 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuar me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.

6. Për sa i përket kategorisë, ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe/ose agjenti tatimor i caktuar nga Bashkia Lushnje bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës.
7. Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të regjistruara si seli të subjekteve tregëtare, Taksa e Ndërtesës përllogaritet dhe paguhet si "Ndërtesa për ushtrim aktiviteti me qëllim përfitimi" me sipërfaqje minimale 16 m^2, për atë pjesë të sipërfaqes së ndërtesës në të cilën ushtrohet veprimtaria tregëtare, përjashtohet nga kategoria "Ndërtesa Banimi".

Neni 8
Lehtësira dhe përjashtimet nga taksa e ndërtesës

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
d) banesat sociale në pronësi të bashkive;
e) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
f) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
g) përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
h) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
i) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
j) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Neni 9
Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së ndërtesës

1. Struktura e Bashkisë Lushnje e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike është Drejtoria e të Ardhurave Vendore.
2. Agjent Tatimor i ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për qëllime banimi në Bashkinë e Lushnje është Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë sh.a, për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2025 do të paguhet së bashku me faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve,pranë sporteleve të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë, dhe Drejtorisë të Ardhurave Vendore, si dhe prane zyres se tatim-taksave në Njësit Administrative përkatëse. **Për familjet që nuk kanë kontratë në "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje" pagesa do të kryhet pranë Drejtorisë të Ardhurave Vendore dhe zyrës së tatim-taksave në Njësit Administrative përkatëse .**

Neni 10
Verifikimi i subjekteve që përjashtohen nga taksa e ndërtesës

1. Strukturat e ngarkuara për verifikimin e subjekteve që përjashtohen nga pagesa e taksës për kategorinë e subjekteve familjarë janë Njësitë Administrative dhe Rajonet e Bashkisë Lushnje.
2. Listat me subjektet e përjashtuara, pasi hartohen nga njësitë administrative dhe rajonet, i njoftohen çdo muaj Drejtorisë të Ardhurave Vendore Vendore.

Neni 11
Dokumentacioni që dorëzohet për të përfituar përjashtimi nga taksa e ndërtesës

1. Subjektet familjarë që përjashtohen sipas nenit 8, të këtij vendimi, depozitojnë pranë Njësisë Administrative/Lagjes ku kanë vendbanimin, dokumentacionin përkatës që vërteton se:
   a. marrin pension pleqërie/pension social;
   b. janë kryefamiljarë që kanë në përbërje të familjes vetëm pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre të paaftë për punë;
   c. trajtohen me ndihmë ekonomike;
   d. kopje të dokumentit ku banojnë që provon se janë pronarë apo përdorues të pasurisë së

paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës etj;

   d. kopje të kontratës/ librezës/ faturës së abonentit kryefamiljar që bën kërkesën për përjashtim.

Neni 12
Mënyra e pagesës

1. Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.
2. Për kategorinë e ndërtesave që shfrytëzohen për banim, detyrimi paguhet në 12 këste të barabarta, për çdo muaj përkatësisht nga çdo taksapagues. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit.
Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit.
3. Për kategoritë e ndërtesave që përdoren për veprimtari ekonomike, detyrimi paguhet brenda datës 30 Qershor.
4. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Qershor, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

KREU III

TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Neni 13
Baza dhe llogaritja e detyrimit

1. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi/përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi/perdorim përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë pronësinë.
2. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar.
3. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.
4. Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, njihen dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në rast mungese të dokumentacionit ligjor verifikimi bëhet nga komisioni i verifikimit të pasurive të paluajtshme i ngritur për këtë qëllim.

Neni 14
Komisioni i verifikimit

Kryetari i Bashkisë ngre komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme për tokën bujqësore. Komisioni verifikon vërtetësinë e vetëdeklarimit të sipërfaqes së tokës bujqësore të dorëzuar nga subjekti taksapagues.

Neni 15
Niveli i taksës

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës Bujqësore	Vlera e taksës në lekë/hektar/vit
I	3920
II	3430
III	2940
IV	2520
V	2100
VI	1680
VII-X	1260

Neni 16
Lehtësira dhe përjashtime

Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Neni 17
Struktura për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore

1. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë së Lushnje, në bashkëpunim me njësinë administrative përkatëse.

2. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Lushnjes dhe bashkëpunimi me Njësitë Administrative dhe rajonet rregullohet me rregullore të veçantë të miratuar nga kryetari i Bashkisë Lushnje.

KREU IV
TAKSA MBI TRUALLIN

Neni 18
Baza dhe niveli i taksës mbi truallin

1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metra katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

2. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror në vit. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim I inivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, janë si më poshtë:

a. Vlera e taksës në lekë/m^2/vit për qëllime banimi nga individët, është 0.56 lekë për m^2 në vit;
b. Vlera e taksës në lekë/m^2/vit, për qëllime biznesi është 20 lekë për m^2 në vit.

3. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim.

Neni 19
Struktura për vjeljen e taksës mbi truallin

1. Struktura e Bashkisë Lushnje e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike është Drejtoria e të Ardhurave Vendore.
2. Agjent Tatimor i ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin që përdoret, shfrytëzohet për qëllime banimi në Bashkinë e Lushnjes është Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë sh.a, për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2025 do të paguhet së bashku me faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve,pranë sporteleve të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë, dhe Drejtorisë të Ardhurave Vendore, si dhe prane zyres se tatim-taksave në Njësit Administrative përkatëse. **Për familjet që nuk kanë kontratë në "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje" pagesa do të kryhet pranë Drejtorisë të Ardhurave Vendore dhe zyrës së tatim-taksave në Njësit Administrative përkatëse .**

KREU V
TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Neni 20
Baza, niveli dhe llogaritja e detyrimit

1. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.
2. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
3. Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit,

pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës.
Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
4. Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre.
5. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
6. Niveli i taksës sipas kategorive, është sipas tabelës Aneksi nr. 3, që i bashkëlidhet ligjit nr.9632/2006 "Per sistemin e taksave vendore"I ndryshuar.

Neni 21

Përjashtimet nga taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë

1. Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat";
c) subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
i. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

2. Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

Neni 22

Agjenti tatimor

1. Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
2. Në rolin e agjentit tatimor, Agjencia Shtetërore e Kadastrës përfiton një komision prej 3 % të shumës së arkëtuar.
3. Struktura e ngarkuar për përgatitjen e Akt Rakordimit me ASHK për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Drejtoria e Planifikimit te Territorit pranë Bashkisë Lushnj

KREU VI

TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Neni 23

Baza dhe niveli i taksës

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri

përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

1. Niveli I taksës është si mëposhte

A-Niveli i takses sipas funksioneve ku baza e takses eshte vlera ne leke e cmimit te shitjes :

1. -Ndërtimi për qellime banimi nga shoqëri ndertimi…… **niveli taksës 4%**
2. -Ndërtimi për godina me funksion kompleks (banim/tregtim/shërbim) nga shoqëri ndertimi …… **niveli taksës 6%**
3. --Ndërtimi për njësi shërbimi …… **niveli taksës 5%**
4. --Ndërtime të tipit magazinë me funksion jobujqësor …… **niveli taksës 4%**

B-Niveli i takses sipas funksioneve ku baza e takses eshte vlera e investimit :

1. -Taksa e ndikimit ne infrastructure per objektet qe legalizohen…**……niveli taksës 0.5%**

   Baza e taksës është kosto e ndërtimit në fuqi për m^2 e marr nga Enti Kombetarë i Banesave.

2. -Leje për stalla, objektet ndihmese fuksionale te stallave apo serave, objekte per tharjen dhe trajtimin paraprak te produkteve, serave me themele te vazhduara (objekte te percaktuara ne VKM Nr.283, date 01.04.2015)……**niveli i taksës 1%**

3 -Leje "Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blektoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin taksa e ndikimit në infrastrukturë…… **niveli i taksës 1 %**

4 -Ndërtimi për qëllime banimi njëfamiljare……**……niveli i taksës 3%**

5 -Për ndërtimet ne infrastrukture si rrugë,ujësjelles,kanalizime,ndriçim publik,telefon,energji(të gjitha keto private),
……**……niveli i taksës 0.1%**

6 -Për objekte per qëllime publike si kopshte,çerdhe,shkolla,spitale(private)…… **niveli taksës 3 %**

7 -Për objektet që destinohen për përdorim ne sektorin e industrisë , turizmit dhe përdorim publik të ndërtuar nga vet individi dhe sipërmarrës,…… **niveli taksës 3 %**

8 -Ndërtim çatie e shfrytëzueshme deri 30%……**……niveli i taksës 3%**

9 -Leje për rrethime pronash……**……niveli i taksës 1%**

10 -Leje për ndryshim destinacioni …… **niveli taksës** sipas kategorive të mësipërme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-bashkia_lushnje @ yahoo.com
Web:www.bashkia lushnje.gov.al

Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

Neni 24

Mënyra dhe afati i pagesës së taksës

1. Taksa paguhet dhe ngarkohet në sistemin elektronik të lejeve brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së autorizimit të pagesës nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Nëse në përfundim të këtij afati kërkuesi nuk ka paguar dhe ngarkuar aktet që provojnë pagimin e taksës, autoriteti përgjegjës i dërgon kërkuesit, nëpërmjet sistemit elektronik, vendimin për refuzimin e lejes së ndërtimit".
2. Për kategoritë ku niveli i taksës aplikohet mbi vlerën e investimit, në përfundim të punimeve të kryera sipas lejes së miratuar, bëhet kontrolli i pagesave me situacionin përfundimtar të objektit të ndërtuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe nëse ka diferenca mes vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar dhe preventivit, njoftohet subjekti për vlerën e diferencës që është i detyruar të shlyejë. Mosshlyerja e këtij detyrimi përbën shkak për pezullimin e procedurave të pajisjes me leje përdorimi të subjektit.

Neni 25

Struktura për për llogaritjen dhe vjeljen e taksës

1. Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

2. Struktura e ngarkuar për përllogaritjen është dhe për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastukturë për ndërtesat në proçes legalizimi është Drejtoria e të ArdhuraveVendore

Neni 26

Përjashtimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse:

1. 1.Investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".
2. investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.
3. investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VII

TAKSA E FJETJES NE HOTEL

Neni 27
Baza dhe niveli i detyrimit

1. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara ne hotel. Janë subjekt i taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.
2. Me "hotel" kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.
3. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.
4. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
5. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.
6. Niveli I taksës

Kategoritë e Njesive akomoduese Hotelerike	Lushnje	Të gjitha njësite administrative jashtë qytetit përkates ,te cilat ju bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi te ligjit Nr.115/2014
Hotel me 4 dhe 5 yje	175	105
Hotel nën 4 yje ,motel, hostel , bujtine, si dhe cdo njesi tjeter akomoduese , te ngjashme me to , sipas përcaktimit te ligjit për turizmin.	70	35

Neni 28
Struktura për vjeljen e taksës

1. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës se fjetjes ne hotel është Drejtoria e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë së Lushnje.
2. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Lushnjes dhe bashkëpunimi me njësitë administrative dhe rajonet rregullohet me rregullore të veçantë të miratuar nga kryetari i Bashkisë Lushnje.
3. Mënyra e deklarimit dhe raportimit për operatorët ekonomikë që janë subjekt i taksës së fjetjes në hotel, kryhet nëpërmjet formularit të deklarimit të taksës së fjetjes të shpërndar nga Bashkia Lushnje.
4. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë apo , në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

KREU VIII
TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA.

Neni 29

Baza, niveli dhe llogaritja e detyrimit

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë dhe caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm3 x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 12,5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse.

Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Kontrolli tenik i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre kryhet brenda periudhës së vlefshmërisë 365-ditore të taksës vjetore të mjeteve të përdorura.

Neni 30
Struktura për përllogaritjen dhe vjeljen e taksës

Drejtoritë Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin, brenda datës 30 të çdo muaji, për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore. Drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njësive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit. Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të faturës për arkëtim, 25 (njëzet e pesë)% të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore, dhe 75 (shtatëdhjetë e pesë)% të të ardhurave, DPSHTRR-ja e derdh për llogari të drejtorisë rajonale, ku është regjistruar (drejtoria rajonale e tatimpaguesve të mëdhenj). Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

KREU IX
TAKSA E TABELËS

Neni 31
Fusha e zbatimit dhe kategorizimet

1. Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet, të cilët vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.
2. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, tabelat kategorizohen në:
   i) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të

tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logo dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një tabele identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.

ii) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

iii) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose jo ballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si në tarraca, llozhe, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare, etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

iv) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

3. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
4. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit, apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës, shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga gërma të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura, apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si mur, fasadë të jashtme të çdo lloji, shtyllë, kollonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë të shkruar, stampuar, apo pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zenë të gjitha shkronjat, figurat, logo dhe simbolet që formojnë tabelën. Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe germa, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produktesh apo shërbimesh që furnizohen nga vetë njësia ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabele. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.

   Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabele identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabele.

Neni 32
Niveli i taksës

Nivelet e taksës së tabelës, sipas kategorizimeve të përcaktuara në nenin 31, jepen si më poshtë:

Nr.	LLOJET E TABELAVE	Nj/matëse	Niveli Taksës
I.	**Taksë tabele për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo , brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)**		
a	***deri në 2 m^2***	Lekë/m^2/vit	0
b	***-mbi 2 m^2 deri 10 m^2***		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m^2/vit	10,000
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m^2/vit	15,000
	-elektronike	lekë/m^2/vit	20,000
c	***-mbi 10 m^2 deri 20 m^2***		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m^2/vit	8,500
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m^2/vit	12,750
	-elektronike	lekë/m^2/vit	17,000
ç	***-mbi 20 m^2 deri 40 m^2***		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m^2/vit	5,500
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m^2/vit	8,250
	-elektronike	lekë/m^2/vit	11,000
d	***-mbi 40 m^2***		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m^2/vit	4,000
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m^2/vit	6,000
	-elektronike	lekë/m^2/vit	8,000
II.	**Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim**		
	-Tabela identifikuese	lekë/m^2/vit	120
III.	**Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme ,e pa lëvizshme deri në tavanin maksimal 35m^2**		
	- e thjeshtë (me/pa ndriçim)	lekë/m^2/vit	22,500
	- elektronike	lekë/m^2/vit	45,000
IV.	**Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle , stenda reklamuese, banderola, etj.**		
	- të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/m^2/ditë	1,000

Shënim:

Në llogaritjen e taksës për tabelat e mëdha se 10 m2, shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10 m^2 do ti shtohet, shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes së mbi 10 m2 të shumëzuar me tarifen përkatëse të taksës. ***P.sh: një tabelë të thjeshte 15 m^2 , shuma e taksës vjetore do të llogaritet :(10 m^2 × 10 000 leke)+(5m^2 x 8500 leke)= 100 000 + 42 500 =***

142,500 lekë/vit (ose 11,875 lekë/muaj).
E njëjta llogjikë llogaritje do të jetë edhe për sipërfaqet e tabelave mbi 20 m^2 dhe mbi 40 m^2.
Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese , vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderihet si e tillë , kurse tabela tjeter do të konsiderohet si reklamë.
Çdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35 m^2 do të konsiderohet sikur është 35 m^2 dhe shuma e tabelës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarësisht madhësisë së saj në m^2.
Në kategorinë e reklames kuptojmë çdo publicitet ,formë promovimi që shërben për të njoftuar, tërhequr vemendjen ose joshur blerësit ,të vendosur ne pamje jo ballore , në tarraca , lozhë ,ballkone , në pjesë të rrugës , shtylla etj., që kanë përmbajtje me qëllime reklamimi për vete ose për të tretë.

Neni 33
Procedura e pajisjes me leje

Për kategorinë **I "Tabelë për qëllime identifikimi**,dhe **II "Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit"**, dhe **III "Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme ,e pa lëvizshme" , IV "Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle , stenda reklamuese, banderola, etj.** për vendosjen e saj çdo subjekt duhet të kryej këto proçedura :

1. Paraqitja e kërkesës me shkrim pranë Drejtorisë së Sherbimeve dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.
2. Paraqitja e planvendosjes.
3. Marrja e miratimit nga Drejtoria e Sherbimeve dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.
4. Pagesa e lejes për vendosjen e reklamës.
5. Lidhja e kontratës dhe pagesa e taksës për qëllime reklamimi

• Për kategorinë **III "Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura (Panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj)"**, detyrimi për taksën e tabelës llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatese të Bashkisë Lushnjë.

Neni 34
Mënyra dhe afati i pagesës së taksës

Taksa e tabelës paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin, si dhe për çdo tabelë të vendosur.
Detyrimi për taksën e tabelës paguhet me një këst të vetëm, i cili paguhet brënda datës 30 Qershor.

Neni 35
Struktura për dhënien e lejes dhe vjeljen e taksës së tabelës

1.Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe mbledhjen e taksës së tabelës është Drejtoria e të Ardhurave Vendore.
2.Struktura e ngarkuar për dhënien e lejeve per tabela apo reklama është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit e cila jep dhe lejet per vendosjen e ketyre tabelave.

TITULLI II

B. TARIFAT VENDORE

Neni 36
Llojet e tarifave

1. **Bashkia Lushnje aplikon tarifat vendore si më poshtë:**
   a. **Tarifë e Autorizimi për pikat e tregëtimit me pakicë të karburanteve dhe njësitë e shitjes së lendëve djegëse dhe bombolave të gazit**
   b. **Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave;**
   c. **Tarifa e gjelbërimit;**
   d. **Tarifa e ndriçimit;**
   e. **Tarifa e parkimit;**
   f. **Tarifa për zënien e hapësirave publike;**
   g. **Tarifa të shërbimit administrativ të Bashkisë Lushnje;**
   h. **Tarifë për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime;**
   i. **Tarifa të institucioneve të varësisë.**

KREU X
DHËNIE AUTORIZIMI PËR PIKAT E TREGËTIMIT ME PAKICË TË KARBURANTEVE DHE NJËSITË E SHITJES SË LENDËVE DJEGËSE DHE BOMBOLAVE TË GAZIT

Neni 37
Fusha e zbatimit dhe kategorizimet

1.Bazuar në Ligjin Nr.8450, datë 24.2.1999 "për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" të ndryshuar me Ligjin Nr .9218, datë 08.04.2004 "për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 "për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 129, datë 18.03.1999 "për proçedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre" të ndryshuar me Vendimet e Këshillit Ministrave Nr. 170, datë 25.04.2002 & Nr. 563, datë 27.08.2004 "për disa shtesa dhe Ndryshime për proçedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të Nënprodukteve të tyre", Bashkia Lushnjë jep autorizime për personat juridikë apo fizikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë Lushnjë.
2. Pagesa për dhënie autorizimi për dy kategoritë e mësipërme është si më poshtë vijon :

Nr.	Emërtimi	Njësia	Tarifa në Lekë
1	Autorizim per funksionimin si stacion shitje te	Për autorizim	1,000,000

	karburanteve,gazi te lengshem te naftes dhe vajrave lubrifikant		
2	Pagesë për dhënie autorizimi për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit të lëngshëm të naftës	Për autorizim	100,000

Shenim: Per dublikate me te njejten permbajtje dhe afat vlefshmerie paguhet 30% e vleres se plote.

Autorizimet mund të jepen për një afat nga 1 deri në 5 vjet,dhe pagesë për cdo vit.

Neni 38
Struktura për vjeljen e taksës

Struktura e ngarkuar për dhënien e këtij autorizimi është Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Lushnjë.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse për piken është Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Lushnjë.

KREU XI

Neni 39

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave.

1. Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë ose ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Lushnje, ne çdo njësi ku ushtrojnë aktivitetin.
2. Pagesa për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave është detyrim vjetor dhe paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore(NIPT sekondar) ku subjekti zhvillon aktivitetin.
   Për Kategorinë " Biznesi " detyrimi paguhet brënda datës 30 Qershor të vitit. Kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50 % të detyrimit.

Nr.	Aktiviteti	Niveli i Tarifës leke/vit							
I	Kategoria dhe nënkategoria Biznes	Biznesi i Vogël *2-5 milion lekë*			Biznesi i Vogël *Mbi 5 milion lekë*			Biznesi i Madh	VIP
		QYTET	Kat. I Njësit Kolonjë Bubullim Krutje Fiershegan Golem Dushk Allkaj	Kat. II Njësit Karbunar Hysgjokaj Ballagat	QYTET	Kat. I Njësit Kolonjë Bubullim Krutje Fiershegan Golem Dushk Allkaj	Kat. II Njësit Karbunar Hysgjokaj Ballagat		
1	*Shitje me pakice/shumice (TREGTI)*							40000	80000

	Bulmet,mish,peshk	10000	7500	5000	15000	10000	6500	-	
	Fruta perime,ushqimore	8000	7000	5000	10000	8000	6000	-	
	Artikuj industriale (veshje,parfumeri,argjendari etj)	8000	7000	5000	10000	8000	6000	-	
	Pub,diskoteka	15000	7500	5000	20000	14000	10000	-	
	Bar,Fast food,kafe internet etj	8000	7000	5000	10000	8000	6000	-	
	Bar restorant,hotel,motel,komplekse turistike,agroturizëm, agrobujtina,pensione	8000	7000	5000	10000	8000	6000	-	
2	***Prodhim***	-			-				
	Subjekte që ushtrojne aktivitet ne fushen e prodhimit	15000	10,000	7000	20000	14,000	10000	70000	140000
3	***Ndertim***	-	-	-	-	-	-	-	
	Subjekte ndërtuese per seline administrative	-	-	-	-	-	-	10 000	20000
	Subjekte ndërtuese per cdo kantier ndertimi	-	-	-	-	-	-	70 000	140000
4	***Shërbim***	8000	7000	5000	10000	8000	6000	40000	80000
5	***Profesione te lira***	8000	7000	5000	10000	8000	6000	40000	80000
6	***Institucione Buxhetore***	-	-	-	-	-	-	40000	-
7	***Shërbimi i transportit***	-	-	-	-	-	-	-	-
	Transport mallrash ***a.Furgona*** ***b.Kamiona***	- 4000 8000	- 4000 8000	- 4000 8000	- 6000 10000	- 6000 10000	- 6000 10000	- 40000 40000	- 80000 80000
	Transport udhetaresh ***a.Taxi 4+1*** ***b.Taxi 8+1*** ***c.Minibuza*** ***d.Autobuza***	- 4000 8000 10000 13000	- 4000 8000 10000 13000	- 4000 8000 10000 13000	- 5000 10000 12000 15000	- 5000 10000 12000 15000	- 5000 10000 12000 15000	40000 - - - -	80000 - - - -
8	***Karburante***	-	-	-	-	-	-	40000	-
9	***OJF dhe Institucionet fetare***	-	-	-	-	-	-	20000	-
10	***Bankat/Institucione Financiare***	-	-	-	-	-	-	50000	-
11	***Tregjet (Zhyme ,Fiershegan etj..)***	15000	15000	15000	20 000	20000	20000	-	-

Për Njësinë Administrativë Bubullim aplikohet për Banker Petroleum sh.a tarifë pastrimi 500.000 lekë/vit **nëse nuk ka adresa te deklaruara ne QKB.*

2. Niveli i tarifës së Pastrimit dhe largimit të mbeturinave per kategorinë familjar është si më poshtë:

- Bashkinë Lushnje (Rajoni nr. 1,2,3,4,5) **2.800 lekë/vit**
- Njësit Administrative:
  Kolonjë ,Bubullim, Krutje, Allkaj, Fier Shegan, Golem Dushk **1.400 lekë/vit**
  Karbunar, Ballagat, Hysgjokaj **800 lekë/vit**

Neni 40

Mënyra e pagesës së tarifës së pastrimit

1. Detyrimi për tarifën e pastrimit është vjetor.

2. Për kategorinë I "Familjarët" detyrimi paguhet në 12 këste mujore. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit. Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit".
3. Për kategorinë I "Familjarët" detyrimi llogaritet dhe paguhet për familje që banojnë brenda territorit të Bashkisë Lushnje. Për të llogaritur detyrimin për tarifën kjo kategori duhet të paraqesë pranë Drejtorisë të Ardhurave Vendore certifikatën e gjendjes familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.
4. Për kategorinë II. "Biznesi" detyrimi paguhet brenda datë 30 Qershor. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.
5.Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet të regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
6. Kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50 % të detyrimit.
7. Të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarifë.
8. Agjenti tatimor i ngarkuar për mbledhjen e tarifës së pastrimit për kategorinë "Familjarë" të cilët kanë kontratë te furnizimit me ujë është shoqëria Ujësjellës Kanalizime Lushnje sh.a, ndërsa për të gjithë familjet e tjera si dhe subjektet e tjera, struktura e ngarkuar është Drejtoria e të Ardhurave Vendore.
9. Në kategorinë Biznes i Madh do ti nënshtrohen tarifës së Pastrimit të gjithë subjektet të cilat janë të regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me përgjegjësi tatimore Tatim mbi Fitimin.

Neni 41
Lehtësira dhe përjashtime

1. Per *Tregjet (Zhyme ,Fiershegan etj..)* , me xhiro 0 (zero) deri ne 2 (Dy) milion Tarifa e Shërbimit Komunitar të jetë 10 000 lekë (pastrim 8 000 lekë, gjelberim 1 000 lekë, ndricim 1 000 lekë)
2. Per Bizneset me xhiro 0 (zero) deri ne 2 (Dy) milion Tarifa e Shërbimit Komunitar të jetë 5 000 lekë (pastrim 3 000 lekë, gjelbërim 1 000 lekë, ndriçim 1 000 lekë)

3. Tarifa e Pastrimit e subjekteve tregtare të klasifikuara si Biznesi i Madh me aktivitet Karburant, në Njësitë Administrative **Kategoria I-rë** të cilat nuk shtrihen përgjate Autostradës Lushnjë – Rrogozhinë , Lushnjë – Fier , Lushnjë – Berat , niveli i tarifës se pastrimit për këto subjekte ulet me 30 %.

4. Tarifa e Pastrimit e subjekteve tregtare të klasifikuara si Biznesi i Madh me aktivitet Karburant, në Njësitë Administrative **Kategoria II-të** të cilat nuk shtrihen përgjate Autostradës Lushnjë – Rrogozhinë , Lushnjë – Fier , Lushnjë – Berat , niveli i tarifës se pastrimit për këto subjekte ulret me 50 %.
5. Kategoritë e përjashtuara nga pagesa e tarifës së pastrimit, ku përfshihen, veteranët,invalidët e punës e luftës, përfituesit e ndihmës ekonomike, të verbrit, të sëmurët tetraplegjik dhe paraplegjikë, si dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuar sipas përkufizimit të ligjit nr. 93/2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara". Për të përfituar nga ky përjashtim, individët duhet të dorëzojnë pranë zyrave të Njësive Administrative, dëshminë e gjendjes së tyre:

a. dokumentin që vërteton kushtin që të jenë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, në certifikatën familjare, si dhe persona të tjerë madhorë të paaftë për punë (invalidë ose fëmijë nën 25 vjeç që ndjekin studimet);
b. librezën e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës e të luftës, statusin e të verbrit, të sëmurëve paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit, vërtetimin e KMCAP, vërtetimin nga Njësia Administrative për përfituesit e ndihmës ekonomike.

6. Përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit prej 3 000 lekë subjektet tregtare që hapen nga të rinjtë deri në moshën 35 vjeç në fushën e agroturizmit të cilësuar si objekt aktiviteti "Agroturizëm" apo "Agrobujtina".
7. Përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit prej 3 000 lekë subjektet person fizik të hapura nga gra/vajza në fushën e punimeve artizanale.
8. Përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit prej 3 000 lekë të rinjtë në moshën 0-35 vjeç që hapin një biznes të ri si profesion I lirë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit.
9. Përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave, kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë

Neni 42
Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për leje ndërtimi

Të ardhurat e krijuara nga kjo tarife, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarife.

Lloji Tarifës /Ndertim	Niveli tarifes/leke
Per leje ndertimi banese ÷ ne 100m2	10 000
Per leje ndertimi banese ÷ ne 250m2	20 000
Per cdo leje ndertimi deri ne 3-kt*	55.000
Per cdo leje ndertimi për shërbimet ÷ në 100 m^2	25.000
Per cdo leje ndertimi për shërbimet ÷ në 250 m^2	50.000
Per cdo leje ndertimi për shërbimet mbi 250 m^2	100.000
Tarife per depozitimin e mbetjeve te ngurta	**20 leke/ m^2**

** Per cdo leje ndertimi deri 3-kt dhe mbi 3-kt dhe subjekte ndertuese per seline administrative e ngarkuar per mbledhjen e Tarifes se Pastrimit dhe Largimit te Mbeturinave eshte Drejtoria e Planifikimit te Territorit, tarife qe duhet ta mbledhi para zbardhjes se Lejes se Ndertimit*

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifë per depozitimin e mbetjeve te ngurta është Drejtoria e Planifikimit te Territorit.

Neni 43
Tarifa e ndriçimit

1.Objekt i kësaj tarife do te jene të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Lushnjes. Pagesa për tarifën e

ndriçimit është detyrim vjetor dhe paguhet për çdo adresë kryesore dhe dytësore (NIPT sekondar) ku subjekti zhvillon aktivitetin.

2.Për Kategorinë " Biznesi " detyrimi paguhet brenda datës 30 Qershor të vitit. Kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50 % të detyrimit.

Nr	Aktiviteti	Niveli i Tarifës lekë/vit							
I	Kategoria dhe nënkategoria Biznes	Biznesi i Vogël *2-5 milion lekë*			Biznesi i Vogël *Mbi 5 milion lekë*			Biznesi i Madh	VIP
		QYTET	Kat. I **Njësit** Kolonjë Bubullim Krutje Fiershegan Golem Dushk Allkaj	Kat. II **Njësit** Karbunar Hysgjokaj Ballagat	QYTET	Kat. I **Njësit** Kolonjë Bubullim Krutje Fiershegan Golem Dushk Allkaj	Kat. II **Njësit** Karbunar Hysgjokaj Ballagat		
1	***Shitje me pakice/shumice(TREGTI)***							5,000	10,000
	Bulmet,mish,peshk	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	-	-
	Fruta perime,ushqimore	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	-	-
	Artikuj industriale(veshje,parfumeri,argjendari etj)	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	-	-
	Pub,diskoteka,lojëra fati	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	-	-
	Bar,Fast food,kafe internet etj	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	-	-
	Bar restorant,hotel,motel,komplekse turistike,agroturizëm, agrobujtina,pensione	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	-	-
2	***Prodhim***	1,750	-	-	-	1,750			-
	Subjekte qe ushtrojnë aktivitet ne fushën e prodhimit	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	5,000	10,000
3	***Ndërtim***	-	-	-	-		-	-	-
	Subjekte ndërtuese për selinë administrative	-	-	-	-		-	5,000	10,000
	Subjekte ndërtuese për çdo kantier ndërtimi	-	-	-	-		-	5,000	10,000
4	***Shërbim***	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	5,000	10,000
5	***Profesione të lira***	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	5,000	10,000
6	***Institucione Buxhetore***	-	-	-	-	-	-	5,000	10,000
7	***Shërbimi i transportit***	-	-	-	-	-	-	-	-
	Transport mallrash	-	-	-	-	-	-	-	-
	a. Furgona	1,500	1,500	1,500	2,000	2,000	2,000	5,000	10,000
	b. Kamiona	1,500	1,500	1,500	2,000	2,000	2,000	5,000	10,000

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJË

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-bashkia_lushnje @ yahoo.com
Web:www.bashkia lushnje.gov.al

	Transport udhëtaresh *a. Taxi 4+1* *b. Taxi 8+1* *c. Minibuza* *d. Autobuza*	- 1,500 1,500 1,500 1,500	- 1,500 1,500 1,500 1,500	- 1,500 1,500 1,500 1,500	- 2,000 2,000 2,000 2,000	- 2,000 2,000 2,000 2,000	- 2,000 2,000 2,000 2,000	5,000 - - - -	10,000 - - - -
8	*Karburante*	-	-	-	-	-	-	40,000	-
9	*OJF dhe Institucionet fetare/Shtetërore*	-	-	-	-	-	-	3,000	-
10	*Bankat/Institucione Financiare*	-	-	-	-	-	-	5,000	-
11	*Tregjet (Zhyme, Fiershegan ...etj.)*	1500	1500	1500	2000	2000	2000	-	-

Neni 44
Mënyra e pagesës së tarifës së ndriçimit

1. Detyrimi për tarifën e ndriçimit është vjetor.
2. Për kategorinë II. "Biznesi" detyrimi paguhet brenda datë 30 Qershor. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.
3.Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet të regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
4. Kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50 % të detyrimit.
5. Të ardhurat e krijuara nga tarifa e ndriçimit, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarifë.
6.Struktura e ngarkuar për vlerësimin dhe mbledhjen e tarifës së ndriçimit është Drejtoria e te Ardhurave Vendore.

7. Në kategorinë Biznes i Madh do ti nënshtrohen tarifës së Ndriçimit të gjithë subjektet të cilat janë të regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me përgjegjësi tatimore Tatim mbi Fitimin.

Neni 45
Lehtësira dhe përjashtime

1. Tarifa e Ndricimit e subjekteve tregtare të klasifikuara si Biznesi i Madh me aktivitet Karburant, në Njësitë Administrative **Kategoria I-rë** të cilat nuk shtrihen përgjate Autostradës Lushnjë – Rrogozhinë , Lushnjë – Fier , Lushnjë – Berat , niveli i tarifës se ndricimit për këto subjekte ulet me 30 %.

2. Tarifa e Ndricimit e subjekteve tregtare të klasifikuara si Biznesi i Madh me aktivitet Karburant, në Njësitë Administrative **Kategoria II-të** të cilat nuk shtrihen përgjate Autostradës Lushnjë – Rrogozhinë , Lushnjë – Fier , Lushnjë – Berat , niveli i tarifës se ndricimit për këto subjekte ulet me 50 %.

3. Përjashtohen nga tarifa e ndriçimit prej 1000 lekë subjektet tregtare që hapen nga të rinjtë deri në moshën 35 vjeç në fushën e agroturizmit të cilësuar si objekt aktiviteti "Agroturizëm" apo "Agrobujtina".
4. Përjashtohen nga tarifa e ndriçimit prej 1000 lekë subjektet person fizik të hapura nga gra/vajza në fushën e punimeve artizanale.
5. Përjashtohen nga tarifa e ndriçimit prej 1000 lekë së rinjtë në moshën 0-35 vjeç që hapin një biznes të ri si profesion I lirë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit

Neni 46
Tarifa e gjelbërimit publik

1.Tarifës së gjelbërimit i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Lushnje.
Pagesa për tarifën e gjelbërimit është detyrim vjetor dhe paguhet për çdo adresë kryesore dhe dytësore(NIPT sekondar) ku subjekti zhvillon aktivitetin.
2. Detyrimi për tarifën e Gjelbërimit është vjetor. Për Kategorinë " Biznesi " detyrimi paguhet brenda datës 30 Qershor të vitit. Kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50 % të detyrimit.

Nr.	Aktiviteti	Niveli i Tarifës lekë/vit							
I	Kategoria dhe nënkategoria Biznes	Biznesi i Vogël *2-5 milion lekë*			Biznesi i Vogël *Mbi 5 milion lekë*			Biznesi i Madh	VIP
		QYTET	Kat. I **Njësit** Kolonjë Bubullim Krutje Fiershegan Golem Dushk Allkaj	Kat. II **Njësit** Karbunar Hysgjokaj Ballagat	QYTET	Kat. I **Njësit** Kolonjë Bubullim Krutje Fiershegan Golem Dushk Allkaj	Kat. II **Njësit** Karbunar Hysgjokaj Ballagat		
1	***Shitje me pakice/shumice(TREGTI)***							2,000	4,000
	Bulmet,mish,peshk	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	-	
	Fruta perime,ushqimore	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	-	
	Artikuj industriale(veshje,parfumeri,argjendari etj)	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	-	
	Pub,diskoteka,lojëra fati	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	-	
	Bar,Fast food,kafe internet etj	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	-	
	Bar restorant,hotel,motel,komplekse turistike,agroturizëm, agrobujtina,pensione	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	-	
2	***Prodhim***	1,750	-	-	-	1,750			
	Subjekte qe ushtrojnë aktivitet ne fushën e prodhimit	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	2,000	4,000
3	***Ndërtim***	-	-	-	-		-	-	-
	Subjekte ndërtuese për selinë administrative	-	-	-	-		-	2,000	4,000
	Subjekte ndërtuese për çdo kantier ndërtimi	-	-	-	-		-	2,000	4,000
4	***Shërbim***	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	2,000	4,000
5	***Profesione të lira***	1,750	1500	1,250	2,000	1,750	1,500	2,000	4,000
6	***Institucione Buxhetore***	-	-			-	-	3,000	6,000
7	***Shërbimi i transportit***	-	-		-	-	-	-	-
	Transport mallrash a. Furgona	- 1,500	- 1,500	- 1,500	- 2,000	- 2,000	- 1,500	- 2,000	- 4,000

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel,fax :+3553522028
e-mail:-bashkia_lushnje @ yahoo.com
Web:www.bashkia lushnje.gov.al

	b. Kamiona	1,500	1,500	1,500	2,000	2,000	1,500	2,000	4,000
	Transport udhëtaresh *a. Taxi 4+1* *b. Taxi 8+1* *c. Minibuza* *d. Autobuza*	- 1,500 1,500 1,500 1,500	- 1,500 1,500 1,500 1,500	- 1,500 1,500 1,500 1,500	- 2,000 2,000 2,000 2,000	- 2,000 2,000 2,000 2,000	- 1,500 1,500 1,500 1,500	2,000 - - - -	4,000 - - - -
8	*Karburante*	-	-	-	-	-	-	50,000	-
9	*OJF dhe Institucionet fetare/shtetërore*	-	-	-	-	-	-	3,000	-
10	*Bankat/Institucionet Financiare*	-	-	-	-	-	-	2,000	-
11	*Tregjet (Zhyme,Fiershegan etj..)*	1500	1500	1500	2000	2000	1500	-	-

Neni 47
Mënyra e pagesës së tarifës së gjelbërimit

1. Detyrimi për tarifën e gjelbërimit është vjetor.
2. Për kategorinë II. "Biznesi" detyrimi paguhet brenda datë 30 Qershor. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.
3.Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet të regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
4. Kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50 % të detyrimit.
5. Të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarifë.
6.Struktura e ngarkuar për vlerësimin dhe mbledhjen e tarifës së Gjelbërimit është Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

7.Në kategorinë Biznes i Madh do ti nënshtrohen tarifës së Gjelbërimit të gjithë subjektet të cilat janë të regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me përgjegjësi tatimore Tatim mbi Fitimin.

Neni 48
Lehtësira dhe përjashtime

1. Tarifa e Gjelberimit e subjekteve tregtare të klasifikuara si Biznesi i Madh me aktivitet Karburant, në Njësitë Administrative **Kategoria I-rë** të cilat nuk shtrihen përgjate Autostradës Lushnjë – Rrogozhinë , Lushnjë – Fier , Lushnjë – Berat , niveli i tarifës se gjelberimit për këto subjekte ulet me 30 %.

2. Tarifa e Gjelberimit e subjekteve tregtare të klasifikuara si Biznesi i Madh me aktivitet Karburant, në Njësitë Administrative **Kategoria II-të** të cilat nuk shtrihen përgjate Autostradës Lushnjë – Rrogozhinë , Lushnjë – Fier , Lushnjë – Berat , niveli i tarifës se gjelberimit për këto subjekte ulet me 50 %.
3. Përjashtohen nga tarifa e gjelbërimit prej 1000 lekë subjektet tregtare që hapen nga të rinjtë deri në moshën 35 vjeç në fushën e agroturizmit të cilësuar si objekt aktiviteti "Agroturizëm" apo "Agrobujtina".

4. Përjashtohen nga tarifa e gjelbërimit prej 1000 lekë subjektet person fizik të hapura nga gra/vajza në fushën e punimeve artizanale.
5. Përjashtohen nga tarifa e gjelbërimit prej 1000 lekë të rinjtë në moshën 0-35 vjeç që hapin një biznes të ri si profesion I lirë në fushën e tekonologjisë së informacionit dhe inovacionit

Neni 54
Tarifa e gjelbërimit për leje ndërtimi

Lloji Tarifës /Ndertim	Niveli tarifes/leke
Per leje ndertimi banese ÷ ne 100m2	3 000
Per leje ndertimi banese ÷ ne 250m2	5 000
Per cdo leje ndertimi deri ne 3-kt	10 000
Per cdo leje ndertimi sherbimet ÷ 250 m^2	15 000
Per cdo leje ndertimi sherbimet mbi 250 m^2	25 000

** Per cdo leje ndertimi deri 3-kt dhe mbi 3-kt e ngarkuar per mbledhjen e Tarifes se gjelberimit eshte Drejtoria e Planifikimit te Territorit, tarife qe duhet ta mbledhe para zbardhjes se Lejes se Ndertimit .*

KREU XII
TARIFA E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE

Neni 49
Fusha e zbatimit dhe mënyra e pagesës

Tarifës së parkimit i nënshtrohen të gjithë tatimpaguesit , personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Lushnje.
Pagesa për tarifën e parkimit është detyrim vjetor dhe paguhet për çdo adresë kryesore dhe dytësore në QKB si dhe për çdo mjet që subjekti posedon në funksion të zhvillimit të aktivitetit.

Neni 50
Niveli i tarifës

Nr.	Lloji Tarifës	Niveli

I	**TARIFË PARKIMI**	
	- autovetura 4 + 1	3 000 lekë/mjet
	- autovetura 8 + 1	5 000 lekë/vit/mjet
	- autobusë	9 000 lekë/vit/mjet
	- minibuza deri në 24 vende	6 000 lekë/vit/mjet
	- auto në vendparkim të miratuar	50 lekë/ditë/mjet
	- automjet transport malli deri 3,5 ton	3000 lekë/vit/mjet
	- automjet transport malli deri 8 ton	5 000 lekë/vit/mjet
	- automjet transport malli deri 14 ton	6 000 lekë/vit/mjet
	- automjete transporti malli mbi 14 ton	8 000 lekë/vit/mjet
	Vendparkime të rezervuara për subjekte private:	
	"Parkim i rezervuar	
	- Autovetura	50 000 lekë/vit
	- Furgona	50 000 lekë/vit
	- Kamiona	50 000 lekë/vit
	Tarifë Parkimi për subjektet me aktivitet "Makina me Qera"	
	ZONA A	
	-Bulevardi Kongresi	10 000 lekë/vit/mjet
	-Bulevardi i Palmave	10 000 lekë/vit/mjet
	-Rruga Misto Mame	10 000 lekë/vit/mjet
	ZONA B	
	Të gjitha rrugët në qytet dhe njësi administrative	3 000 lekë/vit/mjet

Paketa/Abonimi	Orari	Orë/ ditë	Ditë/ vit
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	**08:00 – 20:00**	**12**	**365**

Neni 51
Përjashtimet nga tarifa e parkimit

1. Në të gjitha rrugët çdo kategori parkimi në rrugë pas orë 20:00 deri më 07:30 është parkim i lire ,I pa rezervuar, dhe pa pagesë."
2.Ndalohet vendosja e mjeteve të cilat mund të pengojnë shërbimin e parkimit mbas orarit të miratuar në leje.

Neni 52
Struktura për përllogaritjen dhe vjeljen e tarifës

1. Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së parkimit eshte Drejtoria e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë Lushnjë.

2.Struktura e ngarkuar për pajisjen me leje "Parkim i rezervuar" , vijëzimin e vend parkimeve, vendosjen e tabelave treguese "Parkim i rezervuar" është Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Lushnjë.

KREU XIII
TARIFA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Neni 53
Baza dhe niveli i tarifës

1. Baza e tarifës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në metër katror, e cila kërkohet të shfrytëzohet nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.
2. Niveli i tarifës sipas kategorive dhe nënkategorive :

Nr.	Lloji Tarifës	Niveli
I	**TARIFË PER ZËNIEN E HAPËSIRËS PUBLIKE**	
	-Tarifë per zënie te hapësires publke	90 leke/m^2/muaj
	-Tarifë per zenien e hapësirës publike (Sheshi përpara Bashkise, Pedonalja Abaz Bej Lushnja, Shëtitorja "Kongresi i Lushnjes",Lulishtja e qytetit).	150 leke/ m^2/muaj

3. Detyrimi i tarifës për llogaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj.
4. Pagesa e tarifës për zënie të hapësirës publike:
   a. Për rastin e përdorimit të sipërfaqjes së hapësirës publike me qëllim organizimin e spektakleve ose panaireve të ndryshme, struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës është Drejtoria e të Ardhurave Venodre, pas marrjes së lejes për ushtrimin e aktivitetit në hapësirë publike, nga struktura përkatëse që jep këtë leje në Bashkinë e Lushnje. Kjo strukturë pajis me leje dhe planvendosje të vendit ku do të shfrytezohet.
   b. Për rastin e përdorimit të truallit qëllim ushtrim aktiviteti tregtar në Tregjet Publike të Lushnjes, detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës pranë Drejtorisë të Ardhurave Vendore", në bashkëpunim me Njësinë Administrative përkatëse. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Lushnjes dhe bashkëpunimi me Njësitë Administrative dhe rajonet rregullohet me rregullore të veçantë.
   c. Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim ushtrim aktiviteti tregtar si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, sipërfaqet e zëna me platforma, sipërfaqet e rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to, detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës pranë Drejtorisë të Ardhurave Vendore.

Neni 54
Struktura për mbledhjen e tarifës së hapësirës publike

1. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës për zënien e hapësirës publike është Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në bashkëpunim me njësitë administrative dhe rajonet e Bashkisë Lushnje.
2. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Lushnjes dhe bashkëpunimi me njësitë administrative dhe rajonet e Bashkisë Lushnje rregullohet me rregullore të veçantë.

KREU XIV
TARIFË LEJE NON STOP
Neni 55
Baza dhe niveli i tarifës

1. Tarifës së Leje non-stop 24 orë i, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Lushnje, ne çdo njësi ku ushtrojnë aktivitetin, për aktivitete të cilat zhvillohen 24 orë.
2. Tarifë "leje non stop" është tarifë e cila do të paguhet nga subjekte të cilët do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike **mbas orës 23.00** dhe që do të pajisen me lejen përkatese për të zhvilluar aktivitetin e tyre mbas këtij orari. Leja non stop do tu jepet atyre subjekteve të cilët më parë e kanë kërkuar këtë leje nga Bashkia Lushnjë, kërkesë kjo e cila duhet të jetë e shoqëruar me firmat e mbi ¾ të banorëve të komunitetit të zonës përreth. Hapësira e zonës përreth dhe komuniteti i saj do të vlerësohen nga inspektorët e Drejtorisë së Shërbimeve. Kjo leje do të jepet vetëm pas kryerjes së pagesës së plotë të tarifës së "lejës non stop" nga ana e subjekteve
3. Niveli i tarifës sipas kategorive dhe nënkategorive :

Nr.	Lloji Tarifës	Niveli
I	**TARIFË LEJE NON STOP**	
	- Lojra - fati dhe kazinot	20.000 lekë / muaj
	- Karburante	10.000 lekë / muaj
	- Bar – restorante (ku zhvillohen ceremoni), diskoteka, pub, lokale live	10.000 lekë / muaj
	- Bar – Bufe etj	1.000 lekë / muaj

Neni 56
Agjenti Tatimor

Tarifat e për leje non stop 24 orë arkëtohen nga Drejtoria e Sherbimeve Publike.

KREU XV
TARIFAT E TREGUT:
Neni 57
Baza dhe niveli i tarifës

- TREGU I PERQENDRUAR

a) Te gjithe tregetaret e Tregut te Perqendruar, brenda muajit Janar, jane te detyruar te lidhin kontraten me Bashkine e cila ka afat 1 vjecar (vit kalendarik).

- TREGU I LIRE

Ky treg zhvillohet prane tregut te perqendruar dhe ne ambjentet e tjera te miratuara nga Bashkia si dhe pagesa do te kryhet sipas se tabeles se meposhtme. Pagesa e tarifes se tregut te lire do te behet brenda dates 5 te cdo muaji , me pagese te menjehershme per muajin , ne filialet

e bankave ne Lushnje. Kontrata mujore e tarifes se tregut per tregetaret e tregut te lire do te lidhet nga inspektori i vleresimit te Ambulanteve ne Drejtorine e Të Ardhurave Vendore.

- TARIFA E MARKATËS

Pagesa e Tarifave të Markatës në Lagjjen Xhevdet Nepravishta do të jenë mujore dhe do të paguhen në të gjitha Bankat e nivelit të dytë ose në Posta Shqiptare brenda datës 5 të cdo muaji. Tarifave të Markatës do ti nënshtrohen te gjithë ata tregtarë qe ushtrojn aktivitetin në vëndet e përcaktuara brënda Markatës. Drejtoria e të Ardhurave Vendore e Bashkisë brënda muajit Janar lidh kontrata me të gjithë tregtarët e Markatës. Të ardhurat e krijuara nga këto tarifa i takojne 100 % Bashkisë.

Nr	Emërtimi		Njësia	Niveli Tarifës
A	**1.MARKATA (Lagjja Xhevdet Nepravishta)**			
1	Fruta Perime	Tarifë Pastrimi	Leke/muaj/tregtar	1,500
		Tarifë për zënien e hapësirës publike	Leke/muaj/tregtar	2,000
2	Bulmetore	Tarifë Pastrimi	Leke/muaj/tregtar	1,500
		Tarifë për zënien e hapësirës publike	Leke/muaj/tregtar	2,000
B	*2. TREGU I LIRE*			
	-Tarifa ditore-			
1	Tregtim fruta perime		Leke/tregtar/box	50
2	Tregtim rroba te perdorura		Leke/tregtar/box	50
3	Tregtim industriale te perdorura		Leke/tregtar/box	50
4	Tregtim me makina jashte tregut:		Leke/tregtar/box	150
5	Tregtim peshku		Leke/tregtar/box	200
	-Tarifa mujore -			
1	Tregtim fruta perime		Lek/muaj/tregtar	1,500
2	Tregtim rroba te perdorura		Lek/muaj/tregtar	1,500
3	Tregtim industriale te perdorura		Lek/muaj/tregtar	1,500
C	*3. TREGU NË LAGJE*			
1	Tregtim te sheshi		Leke/muaj	1,500
2	Tregtim ne lagje		Leke/muaj	1,500
D	*4. TARIFË E LENIES SË MALLIT*		**Leke/muaj/tregt**	**500**

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-bashkia_lushnje @ yahoo.com
Web:www.bashkia lushnje.gov.al

E	*Subjekte me aktivitet AMBULANT*	Leke/vit/adresë	**3500**
F	**5.TARIFA PËR FUNKSIONIMIN E TREGUT TË GJËSË SË GJALLË BUBULLIMË**		
	-Tarifa ditore-		
1	Tregtim shpendësh	leke/copë	50
2	Tregtim kafshë të imta	leke/copë	100
3	Tregtim gjedhësh	leke/copë	200
4	Tarifë parkimi për mjetet		
5	Autovetura	lekë/mjet	100
6	Furgona	lekë/mjet	200
7	Kamiona	lekë/mjet	300

Shenim: *Kjo tarife do te vilet sipas akt-marreveshjes se nenshkruar midis paleve.*

KREU XVI
TARIFE PER LICENSE/CERTIFIKATE NE FUSHËN E TRANSPORTIT RRUGOR

Neni 58
Baza dhe niveli i tarifës

Nr	Emërtimi	Njësia	Tarifa në lekë Afati 5 vjecar
I	**TRANSPORT UDHETARËSH** **Brenda vendit**		
	- Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse.	Për linjë	40 000
	- Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse.	Për mjet	5000
	- Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse.	Për linjë	20,000
	- Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse.	Për mjet	7,500
	- Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut.	Për linjë	7,500
	- Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	Për mjet	7,500

	- Licens për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve. - Çertifikat për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetës ndërmjet qarqeve.	Për linjë Për mjet	75,000 7,500
II	**TRANSPORT MALLRASH** **Brënda vendit** - Licensë për transport mallrësh për të tretë dhe me qira brënda vendit. - Çertifikat për transport mallrash për të tretë dhe me qira brënda vendit - Çertifikat për transport mallrash brënda vendit për llogari të vet - Çertifikat për transport mallrash të rrezikshme brënda vendit (për të tret dhe me qira ose për llogari të vet). - Çertifikikat për tërheqës.	 /licensë Ton/kapac Ton/kapac Ton/kapac Për tërheqës	 40,000 100 100 100 7500
	TRANSPORT MALLRASH **Ndërkombëtar:** - Çertifikat për transport ndërkombëtar mallrash për të tret dhe me qira - Çertifikat për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vet. - Çertifikat për transport ndërk, mallrash të rrezikshme(për të tret dhe me qira ose për llogari të vet). - Çertifikikat për tërheqës	 Ton/kapac Ton/kapac Ton/kapac Për tërheqës	 100* 100* 100* 10,000
III	**SHËRBIME TRANSPORTI** - Licencë për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit. - Licencë për agjensi transporti ndërkombëtar udhëtarësh.	 /licencë /licencë	 15,000 40,000
IV	**VEPRIMTARI TË TJERA** - Licensë për transport mallrash me mjete jashtë normave. - Libri i udhëtimit për shërbimet e rastit ndërkombëtar të udhëtarëve. - Libri i udhëtimit për shërbimet e rastit të udhëtarëve brënda vendit - Aurorizim i përkohshëm një mujor.	 /licensë /libër /libër /autorizim	 20,000 **Pa afat** 30 000 5000 2 000
V	- Leje apo çertifikatë vjetore (specifike përveç tarifës së regjistrimit për leje ushtrimi veprimtari ekonomike, bazuar në regulloret përkatëse) për veprimtari servis të automjeteve, lavazheve, parkingut, pika tregëtimi materiale ndërtimi (inerte, gëlqere etj të ngjashme me to) - Licensë vjetore për lejimin e aktivitetit në përgatitjen e kursantëve për automjete (Autoshkolla)	/leje /leje	5,000 5,000

Sqarime :

- Per dublikate me te njejten permbajtje dhe afat vlefshmerie paguhet 30% e vleres se plote.
- Per rastet e ndryshimeve ne license/certifikate qe kane te bejne me elementet e perdoruesit te mjetit, fushes se operimit etj paguhet 30% e vleftes se plote
- Struktura e ngarkuar per vjeljen e tarifes se parkimit te automjeteveeshte Drejtoria e Sherbimeve Publike prane Bashkise Lushnjë.

Afatet e pagesës :

- Per tarifen per license/certifikate ne fushen e transportit rrugor, detyrimi paguhet menjehere me marrjen e licenses/certifikates.

Tarifat e sipërpërmendura janë tarifa të vendosura nga Ministria e Financave, njoftuar Bashkinë Lushnje me shkresën nr. 13786/1, datë 27.01.2010

KREU XVII
TARIFA SHËRBIMESH PËR TRANSPORT TË BASHKISË LUSHNJE

Neni 59
Baza dhe niveli i tarifës

Nr.	Emërtimi Tarifës		Vlera Lekë/Vit
1	Dhënie Çertifikate		1,000
2	Dhënie autorizimi transporti		2,000
3	Dhënie vërtetim transporti		1,000
4	Dhënie leje provizore transporti		1,500
5	Tarifë rregjistrimi vjetor	Per subjekt fizik	1,000
		Per subjekt juridik	2,500
6	Certifikat transporti per transportin e podhimeve vetiake brenda territorit të Bashkise Lushnje		2,000

Të gjitha lejet për zhvillimin e aktiviteteve specifike jepen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Bashkisë Lushnjë.
Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave të shërbimeve të transportit eshte Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Lushnje.

KREU XVIII
TARIFE NDIKIMI NE INFRASTRUKTUREN RRUGORE NGA MJETET E TONAZHIT TE LARTE

Neni 60
Baza dhe niveli i tarifës

Nr.	Emërtimi Tarifës	Vlera Lekë/Vit
1	Tarife per ndikimin ne infrastrukturen rrugore nga mjetet e tonazhit te larte	1,000

Sqarime :

- Kjo tarife paguhet nga drejtuesi i mjetit per cdo kalim (hyrje/dalje) ne piken e kontrollit.
- Kjo tarife aplikohet per mjetet qe kryejne transport mallrash, me tonazh ≥ 7 Ton (pesha e mjetit pa ngarkese, bazuar ne lejen e qarkullimit te mjetit).

- Ne rast mospagese te tarifes nga drejtuesi i mjetit, punonjesit ne piken e kontrollit kane te drejten te sekuestrojne lejen e qarkullimit te mjetit. Ne te tilla raste do te plotesohet procesverbali perkates.

Lehtesirat tatimore:

a) Perjashtohen nga pagimi i tarifës per ndikimin ne infrastrukturën rrugore nga mjetet e tonazhit te larte mjetet qe kryejne transport te udhëtarëve.

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit është Drejtoria e Shërbimeve.

KREU XIX
TARIFA TË SHËRBIMIT ADMINISTRATIV TË BASHKISË LUSHNJË
Neni 61
Baza dhe niveli i tarifës

1) – TARIFA TË SHËRBIMIT ARKIVOR, VËRTETIME NGA ZYRAT DHE KOMISIONE PËR SHËRBIMIN PRANË ARKËS SË BASHKISË

a) Tërheqje Vendime të leje sheshi, leje ndërtimi, leje shfytëzimi dhe njehsim i tyre me origjinalin.....**500 lekë/fletë**
b) Tërheqje e gjithë dokumentave të tjera përveç atyre të sipërpërmendura dhe njehsim i tyre me origjinalin nga Arshiva e Bashkisë Lushnjë.....**100 lekë/fletë**
c) Marrje vërtetimi nga çdo zyrë e Bashkisë Lushnjë.....**200 lekë/vërtetim**

2) – TARIFA TË SHËRBIMIT NË ZYRËN E GJENDJES CIVILE

Ligj Nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtar" i ndryshuar, neni 7 Taksat që vilen nëpërmjet pullës, janë taksa vjetore e akteve të gjendjes civile. Neni 8, pika 2 "ç" Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave ç) për taksën e akteve dhe të pullës 5 për qind; si dhe udhezimi nr. 26, datë 4.9.2008 "Per taksat Kombetare" pika 2/5

1.Për lëshimin e certifikatave për përdorim brenda vendit.....**50 lekë**
2.Për lëshimin e dokumentit "Certifikatë për lidhje martese" në gjuhë të huaj..... **200 lekë**
3.Për lëshimin e dokumentit "Certifikatë lindjeje"në gjuhë të huaj.....**200 lekë**
4.Për lëshimin e dokumentit "Certifikatë martese" në gjuhë të huaj.....**200 lekë**
5.Për regjistrimin e shtetasve të huaj, pas dhënies së shtetësisë shqiptare.....**2,000 lekë**
6.Për procedurën e ndryshimit të emrit/mbiemrit.....**1,000 lekë**
7.Për mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës.....**1,000 lekë**
8.Për procedurën për veçim/bashkim familjesh të shtetasve.....**1,000 lekë**

3) – TARIFA TË SHËRBIMIT TË STREHIMIT

a) Lëshim vërtetimi për të pastrehët.....**200 lekë**

4) – TARIFA TË DREJTORISË JURIDIKE

a) Përgatitje dokumentacioni për privatizim objektesh të kthyera në fond banese.....1,000 lekë
b) Terheqje dokumentave te objekteve te prokurimit.....**2,000 lekë**
c) Vërtetime për tendera.....**500 lekë**

5) – *TARIFA TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE*

a) Leje për ndërhyrje në infrastruktur për vendosje linjash nga operator privat apo publik..... **10,000 lekë**

6) TARIFA PER SHERBIME NE DREJTORINE E TAKSAVE

a) Tarife per leshim Certifikat tatimore..... **1,000 leke**

7) – TARIFA TË DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

1) Shqyrtim dosje per **Deklarate Paraprake dhe Certifikate perdorimi**

5 000 leke person fizik
10 000 leke person juridik

2) Shqyrtim dosje per **Leje ndertimi dhe miratimi perkates prane Bashkise Lushnje**

a) Per objekte deri ne 3 kate mbi toke **5 000 leke**
b) Per objekte mbi 3 kate mbi toke **25 000 leke**
c) Per njesi tregetimi e sherbimi,kapanone,linja prodhimi, depozitimi etj..... **25 000 leke**

3)Tarife per sherbimin e planvendosjes ..... **5 000 leke/flete**

4)Tarife per shtyrje te lejes se ndertimit **10 000 leke**

5) Tarife per transferim leje ndertimi **10 000 leke**

6) ***Tarifat e kontrollit te punimeve***

***a.*Kontrolli i piketimit te objekteve :**

- per objekte deri ne 3 kate mbi toke..... **5 000 lekë**
- mbi 3 kate mbi toke..... **25 000 lekë**

***b.*Kontrolli kuota 00 te objekteve :**

- per objekte deri ne 3 kate mbi toke..... **5 000 lekë**
- mbi 3 kate mbi toke..... **15 000 lekë**

***c.* Kontrolli pas perfundimit te karabinasë :**

- per objekte deri ne 3 kate mbi toke..... **4 000 lekë/kat**
- mbi 3 kate mbi toke..... **6 000 lekë/kat**

***d.*Rifinitura**

- per objekte deri ne 3 kate mbi toke..... **10 000 lekë**
- mbi 3 kate mbi toke..... **20 000 lekë**

***e.*Kontrolli i sistemimit te ambjentit rrethues pas perfundimit te punimeve**

- per objekte deri ne 3 kate mbi toke..... **10 000 lekë**
- mbi 3 kate mbi toke..... **30 000 lekë**

7)Tarife certificate perdorimi :

- per objekte deri ne 3 kate mbi toke..... **30lekë/m^3**
- mbi 3 kate mbi toke..... **50lekë/m^3**

8) Tarife GEN-PLANIT

- per objekte deri ne 3 kate mbi toke..... **40lekë/m^2**
- mbi 3 kate mbi toke..... **40lekë/m^2**

PERJASHTOHEN nga pagesat e tarifave te sherbimit objektet qe i nenshtrohen procedures se thjeshtuar per paisjen me leje ndertimi per shtesat ne zonat rurale dhe objektet nje familjare ne zonat rurale sipas nenit 11 /2 dhe nenit 11/3 te vkm nr.377 date 12.06.2021.

9)TARIFA PËR RAJONET ADMINISTRATIVE

- **Lëshim vërtetimi.....200 lekë/vërtetim**
- Dhënie firme për hipotekimin e pronave private që janë të kufizuara me pronën publike.....**500 lekë**
- Tarife per sherbimin e Planvendosjes (toke bujqesore).....**4,000 lekë/fletë**

10) DREJTORIA MBËSHTETËSE E ARSIMIT LUSHNJË

Kuota ushqimore mujore që paguhet nga prindërit për 4 (katër) kopshtet dhe 2 (dy) çerdhe në territorin e Bashkisë Lushnjë janë si më poshtë vijon :

- Për kopshtet.....**180 lekë/ditë/fëmijë**
- Për cerdhet.....**180 lekë/ditë/fëmijë**
- Për konviktet.....**335 leke/ditë**
  - Pagese paradhënie per garanci kopesht/çerdhe **3,000 leke/vit**
  - Pagese paradhënie per garanci konvikti **6,000 leke/vit**
  - Pagese per vërtetime te ndryshme **200 leke**

11) QENDRA KULTURORE "VAÇE ZELA"

- Tarifa e dhënies në përdorim të sallës Kinoteatrit.....**15,000 lek/orë**
- Tarifa e dhënies në përdorim të hollit Kinoteatrit:
  a) Takime.....**3,000 lekë/orë**
  b) Ekspozitat.....**1,000 lekë/orë**
- Tarifa e dhënies në përdorim të sallës Muzeut.....**5,000 lekë/orë**
- Tarifa e dhënies në përdorim të Teatrit Kukullave..... **5,000 lekë/orë**
- Tarifa për pajisje me fotokopje të gazetave të arkivuara në bibliotekën e qytetit

a) Fotokopje e gazetës në format A3.....**150 lekë/faqe**
b) Fotokopje e gazetës në format A4.....**100 lekë/faqe**

- Vlera e biletës për Kinoteatër.....**100-500 lekë**

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-bashkia_lushnje @ yahoo.com
Web:www.bashkia lushnje.gov.al

- Vlera e biletës për të vizituar muzeun Shtëpinë e Kongresit:
  a) Turistët te huaj.....**200 lekë**
  b) Vizitor te zakonshëm.....**100 lekë**
  c) Nxënës, studenta.....**50 lekë**
- Vlera e biletës për të vizituar muzeun Historik Lushnje:
  d) Turistët te huaj.....**200 lekë**
  e) Vizitor te zakonshëm.....**100 lekë**
  f) Nxënës, studenta.....**50 lekë**

12) TARIFA PËR PËRDORIMIN E AMBJENTEVE SPORTIVE TË MBYLLURA

- Tarifa e dhënies në përdorim të palestrës jashtë ekipit shumësporteve.....**2,000 lekë/orë**
- Tarifa e dhënies në përdorim të palestrës "Foto Puka" për stërvitje ekipesh jo ekipe të klubit shumësporteve.....**10,000 lekë/muaj**

Struktura e Ngarkuar për vjeljen e këtyre tarifave do të jetë Qëndra e Arsimit.

13) TARIFA DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL

- Autorizim për Peshkim amator dhe nënujor.....1,000 lekë/vit

14) TARIFA NDËRMARRJA PASURISË PUBLIKE

- Varrim për Bashkinë Qëndër.....**5,000 lekë**
- Zhvarrim për Bashkinë Qëndër.....**10,000 lekë**

Shënim: Tarifave e varrimit dhe zhvarrimit do të aplikohet vetëm për Bashkinë Qëndër.

15)TARIFAT E UJITJES:

- Tarifa ujitjes me rrjedhje te lire	300 (treqind) leke/dynymi
- Tarifa ujitjes me ngritje mekanike (pompa) leke/dynymi	150(njeqindepesedhjet)
- Tarif e ujitjes se serave	2000 (dymije) leke/dynym/sezon

KREU XX

Neni 62

TARIFAT PËR LLOJE TE SHËRBIMEVE QË OFROHEN NGA SHËRBIMI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

1.Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri për objekte të destinuara për banim

1.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi deri në 12 metër, tarifa është **5 000 (pesë mijë) lekë.**

1.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi nga 12 deri në 24 metër, tarifa është **15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.**

1.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi nga 24 deri në 32 metër, tarifa është **20 000 (njëzet mijë) lekë.**

1.4 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi nga 32 deri në 54 metër, tarifa është **30 000 (tridhjetë mijë) lekë**.

2. Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik (sektori i bujqësisë, sektori i industrisë, sektori i transportit, sektori i tregtisë, sektori i turizmit, sektori i shërbimeve, etj.)

2.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 500 m2, tarifa është **5 000 (pesë mijë) lekë**.
2.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 1 000 m2, tarifa është **10 000 (dhjetë mijë) lekë**.
2.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 2000 m2, tarifa është **20 000 (njëzet mijë) lekë**.
2.4 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 3000 m2, tarifa është **30 000 (tridhjetë mijë) lekë**.
2.5 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi mbi 3000 m2, tarifa është **50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë**.

3. Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, përveç objekteve të përcaktuara në pikën 2, të kësaj shtojce, për objektet/aktivitetet me rrezikshmëri të lartë zjarri

3.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente për përpunimin e drurit me materiale në përpunim dhe/ose në ruajtje, tarifa është **10.000 (dhjetë mijë) lekë.**
3.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për fabrika dhe impiante ku prodhohen, përpunohen dhe/ose mbahen produktet e tekstilit, natyrore/artificiale, produktet e linoleum-it dhe produkte të tjera të ngjashme, tarifa është **10.000 (dhjetë mijë) lekë.**
3.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimentet dhe impiantet për prodhimin, përpunimin dhe rigjenerimin e laboratorëve të gomës, depozitat e gomës, pneumatikëve dhe produkteve të ngjashme, tarifa është **10.000 (dhjetë mijë) lekë.**
3.4 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri

dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për depot ku prodhohen, përpunohen dhe/ose mbajnë plastikë, tarifa është **10.000 (dhjetë mijë) lekë.**
3.5 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimentet dhe impiantet për prodhimin, letër dhe karton, dhe përgatitja e produkteve të letrës në përgjithësi, tarifa është **10.000 (dhjetë mijë) lekë.**

4. Shërbimi për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objektet/aktivitetetkujanëtëinstaluarapajisjenënpresion
4.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për rezervuarë gazi të lëngshëm, në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 75 kg deri në 300 kg, tarifa është **10.000 (dhjetë mijë) lekë.**
4.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për rezervuarë gazi të lëngshëm, në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 300 kg deri në 1000 kg, tarifa është **15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.**
4.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për rezervuarë **20.000 (njëzet mijë) lekë.**
4.4 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/impiante ku lëngjet e ndezshme dhe/ose të djegshme me pikë ndezjeje prodhohen dhe/ose përdoren deri në 125°C, me sasi totale në cikël dhe/ose në ruajtje, më e madhe se 1 m3, tarifa është **10.000 (dhjetë mijë) lekë.**
4.5 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/impiantet për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajrave diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje deri në 5 m3, tarifa është **10.000 (dhjetë mijë) lekë.**
4.6 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/impiante për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajrave diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje deri 100 m3, tarifa është **20.000 (njëzet mijë) lekë.**
4.7 Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/impiante për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajra diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje mbi 100 m3,tarifa është **20.000 (njëzet mijë) lekë.**
4.8 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për sisteme të shpërndarjes së karburantit të lëngshëm, kontejnerët e palëvizshëm të karburanteve të lëngshëm deri në 9 m3, me pikë të ndezjes mbi 65°C, tarifa është **10.000 (dhjetë mijë) lekë.**
4.9 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për sisteme fikse

për shpërndarjen e karburanteve të gaztë dhe tipit të përzier (të lëngshëm dhe të gaztë), tarifa është **20.000 (njëzet mijë) lekë**.
4.10 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për sisteme të shpërndarjes së gazit të karburantit për automjete motorike dhe sisteme të shpërndarjes së palëvizshme për benzinë, naftë dhe miks automobilistik, për përdorim publik dhe privat, tarifa është **20.000 (njëzet mijë) lekë**.

5. Shërbimi për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për bjektet/aktivitetetemëposhtme:
5.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për hidrocentrale, HEC (primar, sekondar) etj., impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, të rinovueshme, diellore, ere, etj., tarifa është **20.000 (njëzet mijë) lekë**.
5.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për vend depozitime të mbetjeve të ngurta, tarifa është **10.000 (dhjetë mijë) lekë**.
5.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për rrugë, hekurudha, ura, tunele, tarifa është **20.000 (njëzet mijë) lekë**.
6. Për vlerësimin dhe miratimin e ndryshimeve të projektit të MZSH-së, të miratuar më parë nga struktura e MZSH-së, për shkak të instalimit të sistemeve të reja, zgjerimit apo ristrukturimit të aktiviteteve ekzistuese, tarifa është **5 000 (pesë mijë) lekë**.
7. Për dhënien e certifikatës së sigurisë nga zjarri, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objektet që ushtrojnë aktivitete, sipas klasifikimit të rrezikshmërisë nga zjarri, tarifa është **5 000 (pesë mijë) lekë**.
8. Për ripërtëritjen periodike të certifikatës së sigurisë nga zjarri, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, tarifa është **2 000 (dy mijë) lekë**.
9. Për lëshimin e vërtetimit të zjarrit (shoqëruar nga raporti i ndërhyrjes), nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, tarifa është **1 000 (një mijë) lekë**.
10. Për lëshimin e vërtetimit (shoqëruar nga akti i kontrollit i kryer nga inspektori i shërbimit të MZSH-së), për depozitat e gazeve të ndezshme, të ngurta, apo plazma në automjete të lëvizshme rrugore, nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, tarifa është **1 000 (një mijë)lekë**.
11. Për inspektimin e objekteve për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kur inspektimi nuk është i autorizuar nga shërbimi i MZSH-së, por kërkohet nga vetë subjektet fizikë dhe juridikë, tarifa është **5 000 (pesë mijë) lekë për një orë**.
12. Për vënien në dispozicion të personelit dhe të një automjeti në zhvillimin e aktiviteteve sportive, kulturore, si panaire, ekspozita, koncerte, shfaqje, festivale të ndryshme, në mjedise të hapura dhe të mbyllura publike, si dhe gjatë zhvillimit të aktiviteteve sportive kombëtare apo ndërkombëtare, tarifa është **10 000 (dhjetë mijë) lekë për një orë**.
13. Për ofrimin e shërbimeve subjekteve private me automjete zjarrfikëse, me pajisje zjarrfikëse, apo me auto shkallë, tarifa është **10 000 (dhjetë mijë) lekë për një orë.**
14. Për ofrimin e shërbimit me motopompë (largim të ujërave për shkak të reshjeve), subjekteve private, tarifa është **5 000 (pesë mijë) lekë për një orë**.

15. Për trajnimin e personave, të subjekteve fizikë dhe juridikë për mbrojtjen nga zjarri nga strukturat e shërbimit të MZSH-së në Akademinë e Sigurisë (Qendra e Trajnimit Zjarrfikës), tarifa është **2 000 (dy mijë) lekë në ditë për person.**
16. Për kryerjen e aktit të ekspertimit apo riekspertimit, nga strukturat e MZSH-së së bashkisë, në rastet e zjarreve të rëna në objekt, kur kërkohet nga subjekte fizikë e juridikë, tarifa është **20 000 (njëzetë mijë) lekë.** Kjo tarifë nuk aplikohet kur akti i ekspertimit kërkohet nga Prokuroria.
17. Për të gjitha ndërhyrjet kur kërkohet nga subjekte fizikë e juridikë (zhbllokime dyersh, ashensorë, apo shërbime të tjera të ngjashme), që do të kryhen nga shërbimi zjarrfikës i bashkisë, tarifa është **2 000 (dy mijë) lekë.**

KREU XXI
LLOJET DHE NIVELET E GJOBAVE QË DO TË VENDOSEN NË RASTET E SHKELJEVE DHE KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE

Neni 63
Baza dhe niveli i tarifës

1. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa liçensë, autorizim apo leje përkatëse të jetë si më poshtë :	
a. Mospajisja me liçensë, autorizim apo çertifikatë përkatëse transporti : □ motokarro □transport udhëtarësh taksi (1+4) □transport udhëtarësh taksi (1+8) □mjete të tonazhit të lartë □hyrja pa autorizim në rrugët kryesore të qytetit për mjetet e tonazhit të lartë	 2.000 lek 10.000 lek 15.000 lek 20.000 lek 15.000 lek
b. Mospajisje me leje për tregëtimin me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndeve djegëse dhe bombulave të gazit	10.000 deri 20.000 lek
c. Mospajisje me leje për tregëti ambulante, kantinë	1.000 deri 5.000 lek
d. Mos pajisje me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit	1.000 lek
e. Mospajisje me leje për ushtrim aktiviteti "24 orësh"	1.000 lek
f. Mospajisje me leje për zenie të hapësirës publike □ekspozim malli □veprimtarive të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike	 5.000 lek 5.000 lek
g. Mospajisje me leje për vendosje reklame : □e thjeshtë □elektronike	 10.000 lek 20.000 lek
h. Mosmarrja e masave për izolimin e ambjentit për daljen zhurmave nga ambjentet e lokaleve.	20.000 lek

2. Mos respektim i rregullave të qarkullimit të jetë si më poshtë:	
a. Parkim të gabuar të mjetit	1000 lek
b. Qarkullim i mjetit duke shkelur rregullat e qarkullimit (sinjalistikës)	500 - 2000 lek
c. Marrja e mjetit me karroatrec	5.000 lek

3. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore të jetë si më poshtë :	
a. Dëmtim rruge	10.000 lek
b. Çarje rruge	20.000 lek
c. Bllokim rruge	15.000 lek
d. Dëmtim bordure	10.000 lek
e. Dëmtim trotuari	10.000 lek
f. Çarje trotuari	20.000 lek
g. Bllokim trotuari	5.000 lek
h. Dëmtim, bllokim, vjedhje pusete	20.000 lek
i. Ndotje të rrugëve nga mjetet e transportit për punime në qytet : - persona juridikë - persona fizikë - qytetarë	 20.000 lek 15.000 lek 10.000 lek

4. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ndriçimit rrugor të jetë si më poshtë :	
a. Lidhje e pamiratuar në rrjetin ajror	20.000 lek
b. Dëmtim të shtyllave të ndriçimit	20.000 lek
c. Dëmtim i ndriçuesve	20.000 lek
d. Përdorimi i shtyllave të ndriçimit si suport për montimin e reklamave, kapjen e kabllove etj.	10.000 lek
e. Dëmtim i traseve, kabllove dhe linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje dhe pa leje si dhe shkulja e shtyllave	20.000 lek
f. Ndërhyrje në kuadrot elektrik public	20.000 lek

5. Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit :	
a. Lidhje e pa miratuar në tubacion	20.000 lek
b. Dëmtim i pusetave	20.000 lek
c. Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje	10.000 lek

6. Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbëra dhe publike të jetë si më poshtë :	
a. Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta	20.000 lekë
b. Dëmtim, prerje e pemëve	20.000 lekë
c. Zënie e hapësires të gjelbër pa leje	10.000 lekë
d. Vendosje tabelash, pankartash, banderolash pa leje	5.000 lekë
e. Vendosje posterash pa leje	100 lekë/copë
f. Mos ndërtimi I bazamenteve të kontenierëve të mbetjeve urbane të subjekteve të ndërtimit për objektet mbi 5 kate	20.000 lekë

7. Niveli I gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në kanale toka bujqësore:	
a. Ndërhyrje dhe dëmtime në kanalë kulluese dhe vaditëse	20.000 lekë
b. Ndërhyrje dhe dëmtime në tokën bujqësore (arë, pemishtë, vreshta,	20 000 lekë

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-bashkia_lushnje @ yahoo.com
Web:www.bashkia lushnje.gov.al

ullishte)	
c. Dëmtim dhe zënie të rrugëve të parcelave pronë private dhe shtetërore	20 000 lekë
d. Zaptim i tokës bujqësore pronë private e përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "për tokën" apo pronë shtetërore	20 000 lekë

8. Niveli i gjobave për ndotje mjedisi:	
a) Djegia e mbetjeve urbane në kontenierë, në Vend Grumbullimin e Mbetjeve (VGM - të), në territore private dhe publike. b) Dorëzimi (hedhja) i mbetjeve në pusetat e elektrikut, ujësjellësit, basenet ujore, etj. c) Dorëzimi i mbetjeve të vëllimshme, mbetjeve të ndërtimit, në kontenierët apo në vendet e grumbullimit të mbetjeve urbane. d) Dorëzimi ditor i mbetjeve urbane në një volum më të madh se ¼ e volumit të një kontejneri publik. e) Dorëzimi në kontenierë i substancave të ngrohta, ndezëse, të rrezikshme për më tepër mbetje të forta apo kafshëve të ngordhura. f) Dorëzimi i mbetjeve nga aktivitete prodhimi, përpunimi, trajtimi, etj. si dhe mbetje të papranueshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në kontenierët publik apo në Vend Grumbullimin e Mbetjeve (VGM – të). g) Hedhja, derdhja ne trotuare e ujërave dhe mbetjeve të ndryshme nga pastrimi apo larja e lokaleve të shërbimit, dyqaneve, etj. h) Dorëzimi i mbetjeve urbane jashtë kontenierëve. i) Hedhja e mbetjeve të çastit, ambalazhet, etj. hapësira publike apo të gjelbra. j) Dorëzimi i pasistemuar, i papalosur apo i pambyllur në qese i mbetjeve tregtarë, si dhe mosdorëzimi i tyre në pikat e grumbullimit të përcaktuara nga Bashkia. k) Moskryerja e pastrimit, lejimi i ndotjes dhe mosmirëmbajtja e territoreve private të zbuluara, për të larguar në çdo mënyrë mbeturinat.	**5,000 lekë dhe dyfishim në raste të raste të përsëritura deri në 20,000 lekë**

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-*bashkia_lushnje @ yahoo.com*
Web:www.bashkia lushnje.gov.al

l) Kryerja e selektimit manual, kërkimit apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontejnerë, etj. nga persona të paautorizuar. m) Ndryshimi arbitrar i Vend Grumbullimit të Mbetjeve (VGM – ve), i kontejnerëve, i pikave të koshave dhe stacioneve të betonuara për hedhjen dhe dorëzimin e mbeturinave të përcaktuara nga Bashkia. n) Hedhja, mbledhja dhe grumbullimi i materialeve, hekurishte apo çdo lloj mbetjeje dhe/ose të rickllueshme, në territore/hapësira publike apo dhe ambiente private që nuk janë miratuar	
b. Parkimi i mjeteve para ose pranë pikave të grumbullimit	**1000 lekë - 5000 lekë**
c. Mospastrimi i hapësirave publike dhe terreneve private, hedhja në territore dhe sipërfaqe publike e mbeturinave, mospastrimi i hapsirave përreth lokaleve ose pikave ambulante të shitjes.	**1000 lekë - 5000 lekë**

9. Niveli i gjobave në ambientin e përbashkët:	
a. Shfrytëzimi i zonave të përbashketa brenda ose jashtë godinës së baniminit,si shkallët,sheshpushimet,tarracat,verandat e përbashkëta,lulishtet dhe vendkalimet nuk do të përdoren për ruajtje,parkime ose të bllokohen. b. Ndalohet shkundja e tapetëve nga ballkoni,apo brenda mjediseve të përbashkët. c. Ndalohet lënia e mbeturinave në ambientet e përbashkët. d. Ndalohet lënia e sendeve të përdorura dhe material ndërtimi në ambientet e përbashkët,qoftë dhe përkohësisht etj. e. Ndalohet vendosja e mjeteve motorike,biçikletë apo sende të tjera personale,nuk duhet të bllokojnë rrugët e hyrjes etj f. Ruajtja e qetësisë në ambientet e përbashkët.	**5,000 lekë**

10. Kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike	
a. Qeni duhet të mbahet nga pronari/kujdestari, me	1000

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-bashkia_lushnje @ yahoo.com
Web:www.bashkia lushnje.gov.al

rrip jo më të gjatë se 1.5 (një pikë pesë) metra. b. Të vendosin maskat mbrojtëse për qentë e racave të rrezikshme: spic, hasky, rotvailer, pitbull, dobermen, qeni i sharrit, pastor, kangalli turk, bokser. c. Të shmangin ndotjen e ambienteve të përbashkëta, në bashkëpronësi dhe hapësirave publike nga kafshët/shpendët e tyre, dhe në rast ndotje, të pastrojnë ambientin pas defektimit. d. Të kryejnë vaksinimin e detyrueshëm vjetor kundër tërbimit. e. Të vaksinojnë dhe kontrollojnë pranë mjekut të klinikës veterinare, kafshët/shpendët e shoqërimit dhe ato të luksit. f. Të respektojnë mirëqenien e kafshëve/shpendëve të tyre. g. Ndalohet kategorikisht, mbajtja në errësirë të plotë, të përhershme dhe/ose të lidhur gjatë gjithë kohës i kafshëve/shpendëve shtëpiake, të shoqërimit dhe të luksit. h. Personat, të cilët mbajnë kafshë/shpendë shtëpiake, të shoqërimit apo të luksit, në banesa individuale apo në bashkëpronësi në zona të urbanizuara, janë të detyruar të mos lejojnë që ato të kryejnë ndotje dhe të shkaktojnë zhurma, duke u bërë shqetësim për pjesëtarët e tjerë të komunitetit, duke cenuar gëzimin e qetë të pronës së tyre. i. Mbajtja dhe/ose rritja e kafshëve, bagëtisë ose shpendëve të çdo lloji, pavarësisht numrit është e ndaluar brenda të gjitha njësive të banimit ose pronës së përbashkët. j. Mbajtja apo qarkullimi i kafshëve blegtoralë jo shtëpiake, në mjedise publike të qendrave urbane si: kuaj, lopë, dhen, dhi, derra, shpendë (pula) etj; b. Ndërsen kafshët kundër njëra – tjetrës ose përdor kafshën për luftime a shfaqje, që shkaktojnë dhimbje, dëmtime, plagosje ose ngordhjen e tyre	(njëmijë)lek Dhe dyfish në rast përsëritje	
k. Ndërsen kafshët kundër njëra – tjetrës ose përdor kafshën për luftime a shfaqje, që shkaktojnë dhimbje, dëmtime, plagosje ose ngordhjen e tyre	10.000(dhjetë mijë)lek Dhe dyfish në	

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-*bashkia_lushnje @ yahoo.com*
Web:www.bashkia lushnje.gov.al

	rast përsëritje	

-Vënia dhe mbledhja e gjobave nga kundravajtjet administrative do të bëhet nga Policia Bashkiake.

-Të ardhurat e realizuara nga mbledhja e gjobave do të ndahen sipas përcaktimit që bën Ligji Nr.10279 datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjen administrative".

Neni 64

Përjashtime

1.Përjashtohen nga pagesa të gjitha rastet e parashikuara me Ligj: ligji nr. 7874, datë 17.11.1994 "per statusin e veteranit te luftes kunder pushtuesve nazifashiste te popullit shqiptar", i ndryshuar, ligjit Nr.7889, datë 14.12.1994 "per statusin e invalidit", Nr.8098, datë 28.3.1996 "per statusin e te verberit", i ndryshuar përjashtohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë si :

- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Tarifa e pastrimit dhe shërbimeve komunitare

Personat:

a. Invalidët dhe veteranët e luftës
b. Invalidët e punës
c. Të verbrit
d. Invalidët papplegjik dhe tetraplegjik që e fitojnë këtë status
e. Personat që trajtohen me ndihmë ekonomike
f. Emigrantet pa shtepi banimi ne Qytetin e Lushnjes

Pasuritë:

a) Pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse,
b) Ndërtesat e banimit, që shfrytezohen nga qiramarrës me qira të paliberalizuara,
c) Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare.
d) Siperfaqet e tokes bujqesore qe mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari per pese vitet e para nga çasti i mbjelljes (e konfirmuar nga Drejtoria Rajonale e Bujqësise dhe Ushqimit Lushnjë).

2.Për kategorine "Personat", pika **a, b, c, d, e,f** zbatohet vetem ne rastet kur është **Kryefamiljar dhe asnjë person nga familja nuk merret me aktivitet biznesi.**
Librezën e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës, statusin e të verbrit, të sëmurëve paraplegjikë e tetraplegjikë, vertetimin e te perndjekurit politik dhe vërtetimin nga Njësia Administrative për përfituesit të ndihmës ekonomike.
3.Mbledhja e tyre do të bëhet nga vetë strukturat e Bashkisë dhe agjentët tatimorë të përcaktuar sipas ligjit.

KREU XXII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 65

Strukturat e ngarkuara për zbatimin e këtij vendimi

Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet: Drejoria e te Ardhurave Vendore, Drejtoria e Finance-Buxhetit, Drejtoria Planifikimit te Territorit, Drejtoria e Sherbimeve Publike, Drejtoria Juridike, Policia Bashkiake, Inpektoriati Ndertimor, Agjentet tatimore, Ndermarjet e Vartesise, Njesit Administrative, Administratorët e Rajoneve, etj...)

Neni 66
Shfuqizime

1.-V.K.B **nr. 102 datë 21.12.2023 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore. administrimin e tyre në Bashkine e Lushnjës dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2024"**, i ndryshuar, shfuqizohet në datë 31.12.2024.
2.- Ky vendim i fillon efektet nga data 1 janar 2025.
3.- Çdo vendim apo parashikim tjetër që bie ndesh me këtë vendim, shfuqizohet.

Neni 67
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Erjet DHIMA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-bashkia_lushnje @ yahoo.com
Web:www.bashkia lushnje.gov.al